



Terma reference për konsulent/ekspertit

Titulli i projektit:	Barazi, mosdiskriminim dhe përfshirje e personave me aftësi të kufizuara përmes vetadvokacisë .
Shtrirja e projektit:	Tiranë, Elbasan, Shkoder
Periudha e zbatimit të projektit:	Janar 2024 – Dhjetor 2024
Shërbimi i kërkuar:	Konsulent per pergatitjen e manualit mbi LMD dhe pershtajen e arsyeshme, perfshire ne formate alternative
Periudha e realizimit të shërbimit të konsulencës:	15 Janar 2024 – 16 Shkurt 2024

Informacion mbi projektin

Në Janar të vitit 2024, FSHDPAK filloi të zbatojë një projekt një vjeçar me fokus Barazinë, Mosdiskriminimin dhe Përfshirjen e Personave me Aftësi të Kufizuara përmes vetë-avokacisë, që shtrihet në tre bashki, Tiranë, Elbasan dhe Shkodër. Ky projekt është financuar nga National Democratic Institute for International Affairs.

Qëllimi i përgjithshëm i projektit është të promovojë respektimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara në Shqipëri përmes nxitjes së mos - diskriminimit dhe përfshirjes. Ndërhyrjet e projektit synojnë (a) fuqizimin e komunitetit të personave me aftësi të kufizuara me qëllim që ata të kërkojnë të drejtat e tyre, kundër diskriminimit dhe për përfshirjen sociale (b) përmirësimi i qasjes në njohuri mbi të drejtat e njeriut dhe legjislacionin e aftësisë së kufizuar, veçanërisht në Ligjin për mbrojtjen nga diskriminimi mes palëve të interesuara shtetërore dhe joshtetërore, si parakusht për të eliminuar diskriminimin dhe ndikuar në përfshirjen sociale.

Qëllimi i shërbimit të konsulencës

Në këtë kuadër, FSHDPAK planifikon të kontrakttojë një ekspert për hartimin e një Manuali mbi Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, përfshire ne formate alternative, easy read, audio dhe sign language.

Kompetenca dhe aftësi të ekspertit:

Eksperti duhet të ketë:

- Diplomë në shkencat sociale, administratë publike, juridik ose të ngjashme;
- Përvojë në fushën e aftësisë së kufizuar, të drejtat e njeriut ose të ngjashme, minimumi 5 vjet;
- Ekspertizë e dëshmuar në konsulencë të ngjashme, përgatitje raportesh, guidash, materialesh informative etj.
- Kapacitet i provuar për të thithur, analizuar dhe sintetizuar sasi të mëdha të informacionit, aftësi të përgatisë materiale të qarta informuese për target grupe që u përkasin grupeve të ndryshme shoqërore,
- Të ketë aftësi të mira komunikuese;
- Të ketë aftësi shumë të mira në planifikimin dhe manaxhimin e kohës.

Produkti që duhet të ofrohen nga konsulenti:

- Manuali mbi Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi;
- Manuali mbi Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi ne formate alternative, easy read, audio dhe sign language.

Të interesuarit të paraqesin dokumentat si më poshtë:

- Curriculum vitae
- Letër shprehje interesi
- Oferte

Dokumentacioni të paraqitet me e-mail, me postë ose dorazi në adresën, brenda datës 10.01.2024.

Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara
Rruga Bogdanwvenr 19, Tirane
E-mail: info@albmail.com